

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ndërsa Rusia shënjestron civilët në Ukrainë, rritet presioni ndaj Trumpit për sanksione
ADRESA	https://dosja.al/bota/ndersa-rusia-shenjestrone-civilet-ne-ukraine-rritet-presioni-ndaj-trumpit-pe-i516647
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHË


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 08:59:55 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 08:48:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	10038a68a52c9a1e2ec49f734204dae144718eb664942383101ee281e44404b4
TEKSTI	2c832b96a19e2149daa7a41b852eab77d20a4e76d7364b95eb392bbf099f5599
PAMJA	9fea71767b405f9965eae148db34d53805086d6372c95c8a39db22ee510d210b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	539819c2cf4f0d97334133ba90a41c8b37660694f0602824ec540a4dfc37d3bf
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	5542c6f376d7530e05241a95b291e64e02f5f89d799222f37a26423635f8fe31
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/539819c2cf4f0d97334133ba90a41c8b37660694f0602824ec540a4dfc37d3bf>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

14 ORE ME PARE

121 ditë revoltë kundër Edi Ramës/
Protestuesit mesazh kryeministrit me
pankarta: Asgjë s'të ndal për të vjedhur, por
SPAK-u ka për ta mbledhur

15 ORE ME PARE

Debate për territorialien te "Ligjet"/
Rrëzohet kërkesa e opozitës për futjen e
draftit të saj në rend dite! Manja: Nuk e
kam në tryezë, duhet të ndjekë procedurën

20 ORE ME PARE

Pagat e magistratëve/ GJL dhe shoqatat e
gjyqtarëve nuk marrin pjesë në tryezën e
Ramës. Kryeministria: Do vazhdojmë
punën për ligjin e pagave

23 ORE ME PARE

Konferenca Ndërparlamentare/ Schieder
tregon detyrat: Kapitujt duhen
mbyllur. Rama: Europa mos të na lërë në
balltë, do jetë dështim

Bota

Ndërsa Rusia shënjestron civilët në Ukrainë, rritet presioni ndaj Trumpit për sanksione

Bombardimet ruse vranë të paktën nëntë persona dhe plagosën më shumë se 80 të tjerë më 28 shtator, sipas zyrtarëve ukrainas.



29 Shtator 2026, 10:48
Nga G.M



Ndërtesa e Akademisë Kombëtare të Shkencave të Ukrainës, pas një sulmi me dronë nga Rusia në Kiev më 28 shtator.

Një valë e re e sulmeve vdekjeprurëse ruse ndaj infrastrukturës civile në qytetet ukrainase po nxit thirrje dypartiake në Uashington që presidenti amerikan, Donald Trump, të përdorë kompetencat e gjera për sanksione të reja ndaj Moskës, ndërsa ligjvënësit argumentojnë se presioni më i madh ekonomik mund t'i forcojë përpjekjet për t'i dhënë fund luftës.

Bombardimet ruse vranë të paktën nëntë persona dhe plagosën më shumë se 80 të tjerë më 28 shtator, sipas zyrtarëve ukrainas. Forcat e Moskës goditën ndërtesa banimi, zyra, qendra të të dhënave dhe Akademinë Kombëtare të Shkencave në qendër të Kievit, në një sulm gjatë ditës.

Në orët e para të 29 shtatorit, autoritetet në Kiev raportuan një valë të re sulmesh ruse, ndërsa gazetarët raportuan disa shpërthime të mëdha në kryeqytetin ukrainas. Ende nuk dihen detajet. Sulmet pasuan një javë përpjekjesh diplomatike në OKB, të cilat synuan të krijonin përparim në negociatat për t'i dhënë fund pushtimit në shkallë të gjerë të Ukrainës nga Rusia, që tani ka hyrë në vitin e pestë.

"Presidenti [i SHBA-së] duhet të veprojë shpejt për të përfutur nga Projektligji i Grahamit për Sanksionet", i tha Radio Evropa e Lirë më 28 shtator republikani Don Bacon, duke iu referuar legjislacionit të miratuar së fundmi.

"Rusët vazhdojnë të bombardojnë qytetet dhe civilët. Amerikanët, në shumicën dërrmuese, duan ta shohin presidentin të ndërmarrë veprime tani", tha Bacon. "Ekonomia ruse është një nga pikat tona të ndikimit dhe ne duhet ta shfrytëzojmë këtë."

Kjo thirrje është pjesë e një përpjekjeje dypartiake dhe dypalëshe në Kongres që Trump ta përdorë Aktin e Lindsey O. Grahamit për Sanksionimin e Rusisë dhe Iranit të vitit 2026, të cilin Kongresi e miratoi me shumicë të gjerë dhe Trump e nënshkroi në ligj këtë muaj.

editoriale

Meri Lika

Opinion kundër mbi një konferencë pa pyetje

Enton Abilekaj

Labirinti i errët i Edi Ramës

Në vëmendje

BOTA 29 SHTATOR 2026, 09:50

Në ditët e fundit të afatit, ish-marinasi amerikan kërkon vëllanë në një kamp refugjatësh afganë në Katar

AKTUALITET 29 SHTATOR 2026, 07:51

Eksperti i sigurisë kibernetike: Hakerat e "Homeland Justice" publikojnë numrat e agjentëve të SHISH

Presioni nga Kongresi

Senatori Roger Wicker, kryetar i Komitetit të Senatit për Shërbimet e Armatosura nga radhët e Partisë Republikane, i bëri gjithashtu thirrje Trumpit më 28 shtator që t'i përdorë mjetet ekonomike të parashikuara me legjislacion për të rritur presionin ndaj presidentit rus, Vladimir Putin.

Në një deklaratë të ndarë me REL-in, Wicker vlerësoi përpjekjet e Trumpit për të ndjekur një marrëveshje të negociuar, por tha se Uashingtoni duhet të mbetet "me këmbë në tokë" përballë Putinit, duke argumentuar se Moska ka vazhduar sulmet ndaj Ukrainës pavarësisht përpjekjeve diplomatike.

"Ai tallet me procesin e paqes", tha Wicker, "por mund të detyrohet ta marrë atë më seriozisht nëse kërcënohet llogaria e tij bankare."

Wicker tha se ligji i jep Trumpit disa mundësi, përfshirë vendosjen e kufizimeve shtesë financiare ndaj bashkëpunëtorëve të Putinit dhe kompanive që mbështesin prodhimin e armëve ruse, sanksionimin e blerësve të mëdhenj të energjisë ruse dhe shënjestrimin e të ashtuquajturës flotën në hije e Rusisë, e përdorur për t'iu shmangur kufizimeve ekzistuese.

"Paqja do të vijë përmes fuqisë amerikane dhe ukrainase, jo përmes vullnetit të mirë të Putinit", tha Wicker, duke i bërë thirrje Trumpit që t'i përdorë kompetencat e reja "në masën më të plotë".

Demokratët që mbështetën legjislacionin po bëjnë gjithashtu presion për zbatimin e tij, me fokus të veçantë në shkurtimin e të ardhurave nga energjia që ndihmojnë në financimin e luftës së Rusisë.

"Do ta monitorojmë nga afër zbatimin e tij", i tha REL-it më 17 shtator senatorja demokrate, Jeanne Shaheen. "Nuk është vetëm pjesa e sanksioneve që ne e konsiderojmë të rëndësishme, por edhe, siç thashë, mbyllja e të ardhurave", tha ajo.

Shaheen tha se presioni duhet të shtrihet përtej Rusisë, te vendet që vazhdojnë të blejnë energji ruse, duke veçuar Kinën. Shaheen bëri gjithashtu thirrje për veprime ndaj transaksioneve që përfshijnë flotën në hije, duke thënë se blerësit nuk duhet të jenë në gjendje të sigurojnë naftë dhe gaz rus përmes rrjeteve jo transparente të tregtimit dhe me çmime të zbritura.

Sulme gjatë ditës

Thirrjet u bënë ndërsa Ukraina raportoi një seri tjetër sulmesh ndaj infrastrukturës civile dhe ekonomike. Sulmet me dronë rusë në rajonin e Kievit vranë katër persona dhe plagosën tetë, thanë zyrtarët. Në Kiev, një grua u vra kur një sulm goditi Akademinë Kombëtare të Shkencave në distriktin Shevchenkivskiy. Forcat ruse goditën gjithashtu një kompani farmaceutike dhe pika karburanti në kryeqytet.

Denys Sienik, i ngarkuari me punë në Ambasadën e Ukrainës në Uashington, i tha REL-it më 28 shtator se sulmet treguan se Moska po zgjeronte shënjestrimin e infrastrukturës ekonomike dhe teknologjike të Ukrainës.

"Këto sulme e bëjnë të qartë se Putini po investon në vazhdimin e luftës, jo në përfundimin e saj - me pasojë shkatërruese për civilët", tha Sienik.

Ai përshkroi njerëzit të bllokuar në ndërtesën e Akademisë Kombëtare të Shkencave, të përfshirë nga zjarri dhe tymi, duke qëndruar pranë dritareve teksa përpiqeshin të shpëtonin.

"Ky nuk është një incident i izoluar, por pjesë e një modeli të vazhdueshëm të agresionit rus që vazhdon të marrë jetë civilësh në të gjithë Ukrainën", tha Sienik.

Ai argumentoi se presioni më i madh përmes sanksioneve është rrjedhimisht "pjesë thelbësore e përpjekjes për paqe", duke thënë se masat që kufizojnë aftësinë e Rusisë për të financuar luftën mund të ndihmojnë në shpëtimin e jetëve.

Ku të ushtrohet presioni?

Legjislacioni i jep administratës amerikane disa rrugë të mundshme për të rritur presionin ekonomik, por ekspertët e sanksioneve thonë se disa nga mundësitë më të menjëhershme përfshijnë objektiva që deri tani i kanë shpëtuar kufizimeve amerikane.

"Shumë prej kompetencave të miratuara në këtë ligj tashmë ishin në dispozicion të presidentit", i tha REL-it Elaine Dezenski, drejtuesja e Qendrës për Fuqinë Ekonomike dhe Financiare në Fondacionin për Mbrojtjen e Demokracive.

"Por ligji do të ofrojë shtysë shtesë për rishikimin e individëve dhe subjekteve që mund t'u nënshtrohen

VIDEO/ Personi më i moshuar i botës banon në Shqipëri, nënë Marra ka lindur 117 vjet e 39 ditë më parë

më të klikuarat

Hakerat iraniane nxjerrin mbi 600 numra të personelit të SHISH-it, publikojnë edhe dokumente konfidenciale

VIDEO/ Ambrozia Meta pyet Ramën për Ergys Agasin, kryeministri largohet me shpejtësi pas gardës

Opinion kundër mbi një konferencë pa pyetje

Të mërkurën Von der Leyen viziton Ballkanin Perëndimor/ POLITICO: BE plan të posaçëm anëtarësimi për Shqipërinë dhe tre vendet kandidatë

insights

Bledian Koka
Pse Rama i denoncoi shqiptarët si antisemitë në OKB

Besmir Semanaj
Kur të bie Diella në kokë

Rezarta Gagani
Përballë pallatit tim po ndërtohet një pallat

Auron Janku
Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Moti

sanksioneve, por që ende nuk janë shënjestruar”, shtoi ajo.

Dezenski veçoi në veçanti flotën në hije të Rusisë dhe subjektet e huaja të përfshira në tregtinë e saj të energjisë.

“Kjo është e rëndësishme, pasi shumë prej anijeve të flotës së hijes së Rusisë mbeten të pasanksionuara”, tha ajo. “E njëjta gjë vlen edhe për shumë prej blerësve kinezë të naftës ruse dhe furnizuesve të projekteve të sanksionuara të infrastrukturës energjetike të Rusisë.”

Sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, ka theksuar se legjislacioni i jep Trumpit hapësirë të konsiderueshme për të vendosur se si t’i zbatojë kompetencat e reja.

“Ligji i jep presidentit kompetenca për vendosjen e tarifave”, u tha Rubio gazetarëve në Nju Jork më 23 shtator, në përgjigje të një pyetjeje të REL-it.

Rubio tha se ligji parashikon gjithashtu përjashtime për arsye të sigurisë kombëtare, duke i mundësuar Trumpit t’i zbatojë masat në mënyrë selektive.

“Ajo që presidenti ka tani në duar është një mjet në kutinë e tij të mjeteve, të cilin mund ta përdorë jo vetëm për të ndikuar në atë që ndodh në Rusi dhe Ukrainë dhe në atë konflikt, por potencialisht edhe në atë që po ndodh me Iranin”, tha Rubio. “Se si do ta përdorë atë është në dorën e tij të vendosë dhe në dorën e tij ta njoftojë.”/REL

rusi ukrainë donald trump rel

Sondazh

Poll

Rusia

29 Shtator 2026, 10:26

Pas më shumë se dy dekadash, SHBA tërheq trupat nga Iraku

Falluxha, Irak IRAK- Shtetet e Bashkuara po përfundojnë tërheqjen e trupave të tyre nga Iraku, duke i dhënë fund një pra...

Jo vetëm Kushner: Tre resorte të tjera po projektohen në zonën e mbrojtur të Zvërnecit

Rusia

29 Shtator 2026, 10:01

Ne ditet e fundit te ardhur, ish-marrmisi amerikan kerkon vellane ne nje kamp refugjatesh afgane ne Katar

Bota

29 Shtator 2026, 09:50

"Evropa te ruhet nga iluzioni i riarmatimit", Papa Leone XIV: Guxim ne negociata dhe te sakrifikojë per paqen

Bota

29 Shtator 2026, 09:09

Gjigandët e IA takohen sot me Donald Trump ne Shtepine e Bardhe, çfare pritet te diskutohet

Bota

29 Shtator 2026, 08:39

Bota

29 Shtator 2026, 08:29

Pas deshtimit te shitjes, BioNTech mbyll fabrikat e vaksinave ne Gjermani, kompania perballet me humbje dhe padi

BioNTech, prodhuesja e vaksinave kundër COVID-19, mbyll tri fabrikat ne Gjermani GJERMANI - Kerkimi disamujor per bleres desht...

18 miliardë dollarë investim/ Trump njofton ndertimin e fabrikes gjigante te celikut ne Iowa: Me e madhe e ne historine e SHBA-se

Bota

29 Shtator 2026, 08:09

Blegtorët i drejtohet qeverise me 7 kërkesa, nga heqja e akcizes te nafta te rialokimi i fondeve

Bota

29 Shtator 2026, 08:09

Ushqimet mbajnë gjallë industrinë, nafta dhe kromi në rënie gjatë 2025

Beta

29 Shtator 2026, 07:28

Netanvahu viziton Emiratet. Abu Dhabi

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.